



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 13.02.2026

MBLEDHJA Nr. 08,
Datë 17.02.2026, ora 12:00
e Bordit të ERE-s.

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të “Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020, e ndryshuar dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Martë, datë 17.02.2026, ora 12:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 08, e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Bordit të ERE-s më datë 04.02.2026 dhe datë 11.02.2026.
2. Mbi kërkesën e shoqërisë “DEVOLL HYDROPOWER” sh.a. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
3. Mbi kërkesën e shoqërisë “TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT” sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
4. Mbi përfundimin e procedurave administrative të nisura për heqjen e licencave të shoqërive “BRECANI R.O.S.P” sh.p.k., “GERTI” sh.p.k., “MOUNTAIN’S GREEN ENERGY” sh.p.k. dhe “TIRANA ENERGJI” sh.p.k.
5. Mbi kërkesën e shoqërisë “PROINFINIT CONSULTING” sh.p.k. për shfuqizimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 304, datë 17.11.2025, “Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë PROINFINIT CONSULTING sh.p.k.”.
6. Mbi kërkesën e shoqërisë “3AD ENERGY” sh.p.k. për marrjen e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të saj si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj “First Investment Bank” sh.a.
7. Çështje të tjera.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI